



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 155

Tiranë – E mërkurë, 6 tetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 20, datë 30.9.2021	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar..... 14569
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 375/1, datë 20.9.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar..... 14569
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 441, datë 5.10.2021	Për miratimin e rregullores “Për shqyrtimin e praktikave korruptive në Këshillin e Lartë Gjyqësor”..... 14569
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 442, datë 5.10.2021	Për miratimin e rregullores “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor”..... 14572
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 443, datë 5.10.2021	Për miratimin e rregullores “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Këshillin e Lartë Gjyqësor”..... 14576

**UDHËZIM**

Nr. 20, datë 30.9.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN
NR. 1, DATË 14.1.2020, “PËR
DOKUMENTACIONIN DHE
PROCEDURAT PËR HAPJEN,
RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E
INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË
LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE
KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË
STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE
BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË
ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; nenet 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar; vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”; dhe vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i asociuar’ dhe ‘Profesor’”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 1, të kreut IV/A dhe pikën 1, të kreut IV/B, të udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020, të ndryshuar, togfjalëshi “brenda datës 30 shtator”, të zëvendësohet me “brenda datës 30 nëntor”.

2. Në pikën 1, të kreut IV/E, të udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020, të ndryshuar, togfjalëshi “brenda datës 30 shtator”, të zëvendësohet me “brenda datës 31 dhjetor”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

URDHËR

Nr. 375/1, datë 20.9.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 633, DATË 17.11.2020, “PËR
NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË
VENDE TË MBYLLURA APO TË
HAPURA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019, si edhe në zbatim të vendimit të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3614 prot., datë 30.8.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi “deri në datën 20.9.2021”, zëvendësohet me togfjalëshin “deri në datën 4.10.2021”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM

Nr. 441, datë 5.10.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR SHQYRTIMIN E PRAKTIKAVE
KORRUPTIVE NË KËSHILLIN E LARTË
GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 61–63, nenet 72–76, nenin 97, pika 1, shkronja “ç” dhe pika 3, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9508, datë 3.4.2006, “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”, me



propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për shqyrtimin e praktikave korruptive në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR KRYETARE Naureda Llagami

RREGULLORE PËR SHQYRTIMIN E PRAKTIKAVE KORRUPTIVE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Kjo Rregullore bazohet në Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9508, datë 3.4.2006, “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”, ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 2 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë tërësinë e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Përgjegjës (më poshtë “Autoriteti”), si dhe zhvillimit e procedurës që lidhet me shqyrtimin e praktikave korruptive, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Neni 3 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

1. Përcaktimi i procedurave, detyrave dhe

përgjegjësi të zbatueshme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, lidhur me denoncimin dhe regjistrimin e praktikave korruptive, shpërblimin dhe mbrojtjen e personave që denoncojnë, përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit, si dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

2. Përcaktimi i rregullave të hollësishme për krijimin, trajtimin, qarkullimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit që bëhet pjesë e dosjes së denoncimit, si dhe shqyrtimin e tij.

Neni 4 Përkufizime

Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Këshilli” është Këshilli i Lartë Gjyqësor që pranon denoncimet sipas ligjit nr. 9508, datë 3.4.2006, “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”.

2. “Autoriteti përgjegjës” është njësi e caktuar brenda Këshillit.

3. “Denoncim” është njoftimi i bërë pranë Këshillit për praktika korruptive, që personat kanë zbuluar, gjetur dhe për të cilat kërkohet ose duhet t’i nënshtrohen kontrollit shtetëror.

4. “Person” është personi fizik ose juridik, vendës ose i huaj.

5. “Praktikë korruptive” është çdo veprim ose mosveprim, i kryer duke abuzuar me autoritetin publik, për sigurimin e përfitimeve të paligjshme për interesa private në dëm të interesave të shtetit apo të shtetasve.

6. “I denoncuar” është një ose me shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një denoncim, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

KREU II PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË DENONCIMIT NGA AUTORITETI

Neni 5 Denoncimi

1. Denoncimi i praktikave korruptive bëhet pranë ambienteve të Këshillit, me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para autoritetit përgjegjës në Këshill dhe dokumentohet me shkrim nga ky i fundit.



2. Denoncimi në të gjitha rastet regjistrohet në një regjistër të veçantë nga ana e protokollit të Këshillit dhe administrohet në dosje të veçanta. Pas regjistrimit, dosja e denoncimit i kalon titullarit të institucionit.

3. Denoncimet anonime trajtohen nga Autoriteti, kryesisht, në të gjitha rastet kur ato përmbajnë të dhëna të besueshme për kryerjen e praktikave korruptive.

4. Kur denoncuesi lidh denoncimin e tij me kërkesën për shpërblim, formulari i kërkesës depozitohet bashkë me denoncimin.

5. Çdo zyrtar që administron dokumente ose fakte të denoncuar, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, zbaton parimet e konfidencialitetit dhe, kur kërkohet nga personi që denoncon praktikën korruptive, siguron ruajtjen e anonimatit të tij.

6. Denoncimi në lidhje me praktikën korruptive të pretenduar, duhet të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën praktikë korruptive dhe rrethanat e kryerjes së tij.

Neni 6

Shqyrtimi i denoncimit

1. Autoriteti përgjegjës pasi njihet me përmbajtjen e dosjes së denoncimit, pas shqyrtimit paraprak, informon titullarin e KLGJ-së lidhur me marrjen e vendimit, për:

a) fillimin e hetimit administrativ për faktet, ngjarjet, rrethanat dhe personat e përmendur në denoncim, si dhe njoftimin e personit të denoncuar për njohjen e tij me materialet e denoncimit dhe të hetimit administrativ;

b) përcaktimin e personave që disponojnë kompetencën dhe funksionet administrative, që lejojnë kryerjen e hetimit, të cilët do të ngarkohen me hetimin, objektin dhe afatin e mbylljes së tij;

c) shtyrjen e afatit, kur merr kërkesë nga personat që janë të ngarkuar me kryerjen e hetimit;

d) arkivimin e denoncimit, për mungesë kompetence, dhe dërgimin e dosjes së denoncimit institucionit kompetent që ka lidhje me objektin e denoncimit;

e) përcjelljen e dosjes së denoncimit për kompetencë organit të prokurorisë, kur çmon se denoncimi përmban të dhëna të mjaftueshme për fillimin e procedimit penal;

f) mosfillimin e hetimit administrativ, arkivimin e denoncimit, kur denoncimi është i pabesueshëm,

i një natyre të përgjithshme dhe i palidhur me rrethana konkrete, dukshëm i rremë ose i bërë me qëllim për të shmangur vëmendjen nga praktika korruptive.

Neni 7

Të drejtat e personave ndaj të cilëve zhvillohen hetime

1. Autoriteti përgjegjës njofton personin e denoncuar për fillimin e hetimit administrativ, duke i dhënë informacion për pretendimet dhe provat përkatëse, si dhe duke e informuar atë për të drejtat e tij.

2. Personi ndaj të cilit po zhvillohen hetime ka të drejtë të njihet me dosjen, të paraqesë pretendime dhe prova brenda afatit të përcaktuar për zhvillimin e hetimit administrativ.

Neni 8

Përfundimi i hetimit

1. Hetimi administrativ përfundon me dorëzimin e raportit nga personi i ngarkuar me hetimin, Autoritetit. Raporti duhet të përmbajë shpjegime rreth fakteve dhe rrethanave të paraqitura, rezultatet e hetimit, si dhe shoqërohet me propozime përkatëse, përfshirë masën e shpërblimit.

Neni 9

Vendimi për rezultatet e hetimit

1. Autoriteti përgjegjës, pasi njihet me raportin e përfundimit të hetimit, informon titullarin e Këshillit lidhur me marrjen e vendimit për rezultatet e hetimit.

2. Autoriteti përgjegjës vendos për një ose disa nga veprimet e mëposhtme:

a) përgatitjen e kallëzimit penal sipas Kodit të Procedurës Penale, kur konstatohet se ndodhet para kryerjes së një vepre penale;

b) fillimin ose paraqitjen e kërkesës për procedim disiplinor për autorët e praktikës korruptive, punonjës në institucion, kur konstatohen shkelje të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës, që përbëjnë shkak për fillimin e procedimit disiplinor;

c) kërkon hartimin e raportit për vlerësimin e dëmit ekonomiko-financiar, shkaktuar shtetit ose të



tretëve, si dhe mënyrën e vjeljes së dëmit, kur konstatohet se mund të ketë dëm ekonomik ndaj shtetit;

d) rekomandim për dhënie shpërblimi për personin që ka kryer denoncimin, së bashku me arsyetimin për masën e shpërblimit të zbatueshëm ose shënimin që kërkesa për shpërblim të refuzohet së bashku me arsyetimin përkatës;

e) kthimin e çështjes për hetim të njëjtit person/grup që ka kryer hetimin ose një personi tjetër, kur konstaton se rrethanat e hetimit të çështjes janë të paplota dhe/ose merr dijeni për fakte apo rrethana të reja, që hedhin dritë për hetimin e çështjes;

f) mbylljen e hetimit, pasi denoncimi është i pambështetur në prova dhe fakte;

g) miratimin ose jo të sugjerimeve të veçanta, të propozuara nga personi që ka kryer hetimin;

h) arkivimin e dosjes.

3. Autoriteti informon denoncuesin dhe personin në ngarkim të të cilit është bërë denoncimi për përfundimet e hetimit.

4. Dosja e denoncimit, në rastet kur është vendosur për shpërblim, nuk mund të arkivohet përpara se personi që ka bërë denoncimin të ketë përfituar shpërblimin.

KREU III MASA E SHPËRBLIMIT, KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 10

Caktimi i masës së shpërblimit

1. Shpërblimi për denoncim caktohet nga titullari i institucionit bazuar në rekomandimet e Autoritetit. Titullari i institucionit përcakton masën e shpërblimit. Urdhri për shpërblimin sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 9508, datë 3.4.2006, “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”, lëshohet nga titullari i institucionit.

2. Për shpërblime sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 9508, datë 3.4.2006, “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”, ekzekutimi bëhet me urdhër të ministrit të Financave, pasi më parë ky i fundit ka dhënë pëlqimin për caktimin e llojit të shpërblimit.

Neni 11

Konfidencialiteti

1. Gjatë të gjithë procedurës, që nga regjistrimi i denoncimit në formë të shkruar ose i deklaruar verbalisht para Autoritetit përgjegjës në Këshill dhe deri në arkivimin e dosjes, të gjithë nëpunësit e Këshillit, ndër të cilët kalon dosja, duhet të ruajnë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me denoncimin, duke mos e përhapur ose transmetuar te persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të denoncuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

2. Qarkullimi i dosjes bëhet në mënyrë konfidenciale dhe marrja e saj në dorëzim bëhet me nënshkrimin e nëpunësit, i cili e merr dosjen në dorëzim në një regjistër të veçantë që administrohet nga Sektori i Protokoll-Arkivit dhe ku evidentohen saktë të gjitha lëvizjet e dosjes.

Neni 12

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 9508, datë 3.4.2006, “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

VENDIM

Nr. 442, datë 5.10.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 61–63, nenet 72–76, nenin 97, pika 1 shkronja “ç” dhe pika 3, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e



qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, nenin 13, pika 10, të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

RREGULLORE PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në KLGJ-së, bazohet në Kodin e Procedurave Administrative, në ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 16.11.2016, “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave që do të ndiqen pranë Këshillit të Lartë

Gjyqësor, për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të ndryshuar.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë Rregullore termet e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

2. “Këshilli” është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. “Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.

4. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit të “Njësia përgjegjëse” ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës.

5. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

6. “Sinjalizues” është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune ose ka punuar më parë pranë KLGJ-së, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

7. “Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në KLGJ, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, se mund të përbejë korrupsion.

8. “Ligji për sinjalizimin” do të nënkuptojë ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të ndryshuar.

KREU II VEPRIMTARIA E “NJËSISË PËRGJEGJËSE”

Neni 4 Parimet e veprimtarisë

1. “Njësia përgjegjëse” për zbatimin e ligjit për sinjalizimin bazohet në parimin e:



a) ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror;

b) njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;

c) sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit;

d) integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;

e) zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;

f) procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

KREU III PROCEDURAT E VEPRIMIT

Neni 5

Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të “Njesisë përgjegjëse” kryhen në përputhje me ligjin për sinjalizimin, dhe për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë Rregullore, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat “Njësia përgjegjëse” cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 6

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para “Njesisë përgjegjëse” të caktuar dhe dokumentohet me shkrim prej kësaj të fundit.

2. Sinjalizimi përmban të paktën:

a) të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;

b) të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;

c) përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;

d) referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;

e) në rastin e sinjalizimit tek ILDKPKI-ja, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.

3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga “Njësia përgjegjëse” si i tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.

4. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme, sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

Neni 7

Mosfillimi i hetimit administrativ

1. “Njësia përgjegjëse” ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ, nëse:

a) sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;

b) sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij;

c) kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.

Neni 8

Hetimi i drejtpërdrejtë nga ILDKPKI-ja

1. Sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprën e dyshuar të korrupsionit tek ILDKPKI-ja, në rastet kur:

a) “Njësia përgjegjëse” nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 60/2016;

b) ekziston dyshimi i arsyeshëm se nëpunësit e “Njesisë përgjegjëse” ose persona të lidhur me ta janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal, në veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Sipas rastit, person i lidhur ka të njëjtin kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin për



tregtarët dhe shoqëritë tregtare ose ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;

c) ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e nëpunësve të “Njësia përgjegjëse” në shqyrtimin e sinjalizimit;

d) prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, mund të fshihet ose të shkatërrohet nga KLGJ-ja.

2. Në rastet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, çdo hetim i “Njësia përgjegjëse”, nëse ka filluar, ndërpritet dhe sinjalizimi hetohet në vijim nga ILDKPKI-ja. Në rast se, nga ILDKPKI-ja nuk vërtetohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, “Njësia përgjegjëse” nis ose vijon hetimin administrativ pasi ka marrë vendimin e arsyetuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

KREU IV HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 9

Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokollit dhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve, i cili mbahet sipas ligjit për sinjalizimin dhe aktet nënligjore të tij.

2. “Njësia përgjegjëse” nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 10

Hetimi administrativ nga “Njësia përgjegjëse”

1. Në kryerjen e hetimit administrativ “Njësia përgjegjëse” vepron:

a) me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitime të sinjalizuesit;

b) në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;

c) duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;

d) duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;

e) duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojtje të dhënave në përmbajtje të çdo sinjalizimi;

f) duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

Neni 11

Procedura e hetimit administrativ

1. “Njësia përgjegjëse” heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

2. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga “Njësia përgjegjëse”.

3. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:

a) mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;

b) mund të konsultohet me dosjen e hetimit;

c) ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.

4. “Njësia përgjegjëse” njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, “Njësia përgjegjëse” është e detyruar t’i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.

5. “Njësia përgjegjëse” merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për atë që është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.

6. Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga “Njësia përgjegjëse” rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, “Njësia përgjegjëse”, sipas rastit, vë në dijeni organet kompetente.



Neni 12

Provat në hetimin administrativ

1. “Njësia përgjegjëse” dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ.

2. “Njësia përgjegjëse” ka të drejtë të këqyrë sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit.

3. Në raste të veçanta, kur “Njësia përgjegjëse” vlerëson se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, bllokun dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara.

Neni 13

Përfundimi i hetimit administrativ

1. “Njësia përgjegjëse” përfundon hetimin administrativ, nëse:

a) gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, “Njësia përgjegjëse” njofton menjëherë organet kompetente;

b) sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 60/2016.

2. Në dosjen e sinjalizimit administrohet akti për përfundimin e hetimit administrativ nga “Njësia përgjegjëse”, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

KREU V

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 14

Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.

2. “Njësia përgjegjëse” duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e

lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar te persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

Neni 15

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 60/2016. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU VI

AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT ADMINISTRATIV

Neni 16

Afati për vendimarrjen

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga “Njësia përgjegjëse” përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.

VENDIM

Nr. 443, datë 5.10.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË
KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR
MBROJTJEN NGA HAKMARRJA NË
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 61–63, nenet 72–76, nenin 97, pika 1, shkronja “ç” dhe pika 3, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 24, pikat 4 dhe 13, pika 10, të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, me propozim të



Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar.

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

RREGULLORE PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR MBROJTJEN NGA HAKMARRJA NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Baza ligjore**

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor (Këshilli), bazohet në ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative, VKM nr. 816, datë 16.11.2016, “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësive përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Neni 2 **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, në zbatim të ligjit nr.

Neni 3 **Përkufizime**

Në këtë rregullore, termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Hakmarrje” është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim, i kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.

2. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligjit nr. 60/2016, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

3. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

4. “Mbrojtje” është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V, të ligjit nr. 60/2016.

5. “Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.

6. “Këshilli” është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

7. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit të njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

8. “Sinjalizues” është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

9. “Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.



KREU II VEPRIMET PROCEDURALE

Neni 4 Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të “Njësise përgjegjëse” kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 5 Mbrotja kundër hakmarrjes

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas ligjit nr. 60/2016, mbrohet ndaj çdo masë hakmarrëse të marrë ndaj tij nga Këshilli, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a) shkarkimin nga puna;
- b) pezullimin nga puna ose të një, ose më shumë detyrave;
- c) transferimin brenda ose jashtë organizatës;
- d) uljen në detyrë;
- e) uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
- f) humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
- g) mosngritjen në detyrë;
- h) heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- i) vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
- j) forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.

2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.

3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të Këshillit, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, paraqet kërkesë me shkrim. Njëkohësisht, një kopje e saj i dërgohet inspektorit të përgjithshëm të ILDKPKI-së nga sinjalizuesi.

4. Strukturat përgjegjëse pranë Këshillit marrin masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë dhe njoftim të sinjalizuesit brenda 5 (pesë) ditësh.

KREU III HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 6 Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje

1. Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, që ka ndodhur ose është duke ndodhur, fillimisht duhet të paraqesë kërkesë për mbrojtje te njësia përgjegjëse e Këshillit.

2. Kërkesa regjistrohet në një regjister të posaçëm që krijohet dhe mbahet nga njësia përgjegjëse. Regjistri përmban të dhënat që vlerëson njësia përgjegjëse si të nevojshme që të pasqyrohen dhe janë të rëndësishme në një proces hetimi të kërkesës për mbrojtje, por domosdoshmërisht duhet të përmbajë informacion, lidhur me identitetin e sinjalizuesit (nëse sinjalizuesi nuk ka vlerësuar të mbetet anonim), numrin e regjistrimit të kërkesës dhe datën e regjistrimit të saj, personin/at për të cilët pretendohet se kanë ndërmarrë akt hakmarrje/vendimet që merr njësia përgjegjëse.

3. Brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e kërkesës për mbrojtje, njësia përgjegjëse njofton sinjalizuesin për regjistrimin e kërkesës, ashtu si dhe mund t'i kërkojë informacion shtesë, të dhëna të tjera që mund të shërbejnë në identifikimin dhe provueshmërinë e aktit të hakmarrjes, të ndërmarrë ndaj tij. Kërkesa për të dhëna shtesë nga sinjalizuesi, nuk përbën shkak që njësia përgjegjëse të mos vijojë hetimin e pretendimeve për hakmarrje.

4. Njësia përgjegjëse merr menjëherë masat dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes.

Neni 7 Hetimi administrativ

1. Njësia përgjegjëse heton administrativisht pretendimet për hakmarrje për të përcaktuar nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur, është duke ndodhur, ose pritet të ndodhë një akt hakmarrjeje.



Neni 8

**Mjetet e kërkimit të provës
dhe barra e provës**

1. Gjatë hetimit administrativ njësia përgjegjëse me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen mund:

a) të mbledhë deklaratat nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;

b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;

c) të vizitojë vende të caktuara.

2. Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes së aktit të hakmarrjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, njësia përgjegjëse kryesisht apo me kërkesën e sinjalizuesit, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).

3. Njësia përgjegjëse që zhvillon procedurën administrative mund të vendosë sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi “Njësinë përgjegjëse”.

KREU IV

AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT

Neni 9

**Masat në përfundim
të hetimit administrativ**

1. Nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit, njësia përgjegjëse njofton strukturat përkatëse pranë Këshillit, sipas legjislacionit në fuqi, për marrjen e të gjitha masave për riparimin e shkeljes së kryer.

2. Njoftimi i adresohet kryetarit të Këshillit, si dhe në rastet kur sinjalizuesi është nëpunësi civil, njoftimi i adresohet edhe Sekretarit të Përgjithshëm ashtu si dhe në çdo rast eprorit të drejtpërdrejtë të sinjalizuesit.

Neni 10

Afati i përfundimit të hetimit administrativ

1. Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Neni 11

Dispozita të fundit

1. Ngarkohet njësia përgjegjëse që brenda 10 ditëve nga miratimi i rregullores të miratojë regjistrin sipas parashikimeve të pikës 2, neni 6 i saj.

2. Brenda datës 10 janar të çdo viti, njësia përgjegjëse përgatit një informacion drejtuar kryetarit të Këshillit dhe Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me veprimtarinë në funksion të objektit të kësaj rregulloreje. Ky informacion përcillet brenda datës 15 janar të çdo viti pranë ILDKPKI-së.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë